



SHOQËRIA KONÇENSIONARE AYEN-ALB SHA

PËRMBLEDHJA E RAPORTIT

TITULLI I PROJEKTIT	HIDROCENTRALI KALIVAÇ
TITULLI I DOKUMENTIT	RAPORT TEKNIK



RISH.	QËLLIMI I PUBLIKIMIT	PËRSHKRIMI	PËRGATITI	DATA
1	Raporti Teknik		AYEN-ALB	22/07/2019
2				
3				
4				

APROVIMI I VERSIONIT FINAL

	KONSULENTI			KLIENTI	
	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi	Kontrolloi	Aprovoi
Emer/Mbiemër	AYEN-ALB	AYEN-ALB	AYEN-ALB		
Firma					

PËRMBLEDHJE

Përmbledhje	1
1. Qëllimi i projektit te propozuar.....	2
2. Vendndodhja e zonës së projektit.....	2
3. Qendrat banuara.....	4
4. Objektet dhe strukturat e projektit.....	6
5. Përshkrimi i Proceseve Ndërtimore dhe Teknologjike	10
6. Lidhja me infrastrukturën e nevojshme.....	12
7. Fazat e zhvillimit te projektit	13
8. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin	14
9. Lidhja e projektit me projektet e tjera ekzistuese përreth/pranë zonës se projektit..	15
10. Informacion për alternativat e marra ne konsiderate.....	15
11. Lëndët e para gjatë funksionimit,	15
12. Aktivitete të tjera.....	15
13. Informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin	18
14. Kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi	18



1. QËLLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

Hidrocentrali i Kalivaçit do të ndërtohet sipas kontratës koncesionare të lidhur midis palëve, AYEN-ALB sh.a. në cilësinë e koncesionarit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e autoritetit kontraktues. Hidrocentrali do të ndërtohet mbi lumin Vjose në afërsi të fshatit Kalivaç me qëllim prodhimin e energjisë elektrike. Për prodhimin e energjisë hidrocentrali do të shfrytëzojë kuotat ujore midis 73 m m.n.d. dhe 113 m m.n.d. Fuqia e instaluar e hidrocentralit do të jetë 111 MW dhe prodhim vjetor i llogaritur do të jetë 366.62 GWh.

2. VENDNDODHJA E ZONËS SË PROJEKTIT




Figura 1: Vend-ndodhja e projektit

Ndërtimi i Hidrocentralit Kalivaç

Projekti do ndërtohet mbi lumin Vjose ne ngushticën pranë fshatit Kalivaç. Projekti ndodhet ne jug te Shqipërisë, si tregohet ne figurën 1, dhe zhvillohet kryesisht ne prefekturën e Gjirokastrës dhe një pjese e vogël e tij ne prefekturën e Vlorës. Diga e hidrocentralit ka largësi automobilistike 180 km nga Tirana, 61 km nga Gjirokastra dhe 83 km nga Vlora. Bashkia me e afërt me digën e hidrocentralit është ajo e Memaliajit e cila ndodhet 25 km ne largësi automobilistike. Koordinatat e ve ndodhjes së veprave të hidrocentralit, sipas sistemit Gauss Kruger janë paraqitur ne tabelën 1 ndërsa harta topografike është paraqitur ne figurën 2.

Tabela 1: Koordinatat e vendodhjes së veprave të hidrocentralit, në sistemin Gauss Kruger

Emërtimi i Veprave	Koordinatat	
	X (east)	Y (north)
Diga e Hidrocentralit	4398640.26	4474328.644
Tuneli i Deviacionit	4398421.341	4474719.697
Vepra e Marrjes	4398902.73	4474275.81
Shkarkuesi Sipërfaqësor	4398721.433	4474402.489
Godina e Centralit	4398716.593	4474469.756
Godina e Nënstacionit	4398691.38	4474530.954





Figura 1: Harta topografike

3. QENDRAT BANUARA.

Zona e projektit që shtrihet nga pjesa veri-perëndimore e Gjirokastrës dhe pjesa lindore e qarkut të Vlorës. Zhvillohet në territorin e Bashkive që kanë të bëjnë me qarqet e Gjirokastrës dhe Vlorës: respektivisht Bashkitë Memaliaj dhe Tepelenë të cilat janë pjesë e Qarkut të Gjirokastrës dhe Bashkitë Selenicë dhe Vlorë, pjesë e Qarkut të Vlorës.

Projekti zhvillohet në tetë njësi administrative të katër bashkive: Krahës, Qesarat, Memaliaj Fshat, Qendër Tepelenë, Lopës, Sevaster, Vllahinë, Qendër Vlorë. Një listë e detajuar e të gjitha qarqeve, komunave dhe njërive administrative, fshatrat e të cilave do të jenë pjesë e bazës social-ekonomike është dhënë në Tabelën 15.

Tabela 2 Organizimi administrativ i zonës bazë social-ekonomike.

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësitë administrative	Fshatrat
1	Gjirokastrë	Memaliaj	Krahës	Kalivaç, Leshnje, Përparim, Lulëzim,
2			Memaliaj Fshat	Memaliaj Fshat, Vasjar, Mirinë
3			Qesarat	Qesarat, Ilirias, Anë- Vjosë, Toç
4		Tepelenë	Qendër Tepelenë	Dukaj (Kordhaj), Salari
5			Lopës	Sinanaj, Dhëmblla, Lap Martalloz, Matohasanaj, Dorëz
6	Vlorë	Selenicë	Sevaster	Shkozë, Sevaster, Golimbas
7			Vllahinë	Mallkeq, Gërnec, Ondriç, Peshkëpi
8		Vlorë	Qendër Vlorë	Xhyherinë, Babicë e Madhe

Zona e drejtpërdrejtë e studimit të projektit për vlerësimin e bazë sociale përfshin vendbanimet afër dhe brenda zonës së prekur nga projekti. Kjo konsiderohet të jetë zona më e ndikuar (zona kryesore e ndikuar) dhe prandaj do të studiohet në detaje më të hollësishme.

Zona e studimit klasifikohet në dy zona: vendbanimet e prekura drejtpërdrejt nga liqeni (shumë të ndikuara) dhe i përkasin Bashkisë së Memaliajt dhe, në një masë më të vogël, asaj të Tepelenës. Në zonën e dytë janë vendbanimet që do të ndikohen nga linja e transmetimit ku projekti pritet të shkaktojë një ndikim më të vogël ose indirekt, zonë që i përket Bashkisë Selenicë dhe, në një masë më të vogël, asaj të Vlorës. Në zonën e përgjithshme të studimit ndodhen 27 vendbanime.

Vendbanimet e Bashkisë Memaliaj, si; Kalivaçi, Qesarati, Ilirasi, Anë Vjosa janë qendrat kryesore urbane në bashkinë e Memaliajt, ku priten ndikimet kryesore të projektit. Prandaj, janë planifikuar studime më të hollësishme për zonat e prekura.



4. OBJEKTET DHE STRUKTURAT E PROJEKTIT

Objekte me te rëndësishme te hidrocentralit janë paraqitur ne tabelën 1 dhe janë, Tuneli i Deviacionit, Diga e Hidrocentralit, Vepra e Marrjes, Shkarkuesi Sipërfaqësor, Godina e Centralit dhe Godina e Nënstacionit, plan vendosja e projektit është dhëne ne figurën 3.




Figura 3: Plan vendosja e projektit

Tuneli i deviacionit, i cili pas përfundimit te ndërtimit te veprës do te shërbeje si shkarkues fundor, është vepra e pare qe do te ndërtohet. Gërmimet për ndërtimin e tunelit kane përfunduar dhe ka mbetur vetëm betonimi i tunelit, materialet qe do te përdoren për ndërtimin e tunelit te deviacionit janë beton dhe hekur ndërtimi, planimetria gjatësore e tunelit te deviacionit është dhëne ne figurën 4. Me mbarimin e tunelit te deviacionit do te filloje puna paralelisht për instalimin e tubave te presionit, ndërtimin e shkarkuesit sipërfaqësor dhe mbushjes se trupit te digës me gurë. Ne momentin qe mbushja e digës arrin kuotën fundore te shkarkuesit sipërfaqësor do te filloje ndërtimi i godinës se centralit dhe nënstacionit.

Ndërtimi i Hidrocentralit Kalivaç




Figura 4: Planimetria gjatësore e tunelit te deviacionit.




Figura 5: Seksioni tip i trupit te digës

Diga e hidrocentralit do te ndërtohet me mbushje me gurë dhe me ekran betonarme. Ne figurën 5 është paraqitur seksioni tip i trupit te digës, nga e majta ne te djathte, struktura e pare është galeria e çimentimeve e cila do te shërbeje për ndërtimin e perdes se çimentimit. Mbështetur ne galerinë e çimentimit do te ndërtohet ekrani betonarme i cili do te shërbeje si izolues i ujit dhe se fundmi trupi i digës i cili do te përballoje gjithë forcat statike dhe dinamikes si gjate ndërtimit te veprës ashtu edhe gjate operimit te saj. Materialet qe do te përdoren për ndërtimin e digës janë gurë te cilët do te merën ne bjeftin e sipërm te digës ne sipërfaqen e cila do mbulohet nga uji i rezervuarit duke minimizuar ne maksimum impaktin ne mjedis, beton, hekur ndërtimi si dhe injeksion çimentojë i cili do te përdoret për ndërtimin e perdes se çimentimit.




Figura 6: Vepra e marrjes dhe tubacioni i presionit

Vepra e marrjes dhe tubacioni i presionit do të shërbejnë për marrjen e ujit në rezervuar dhe dërgimin e tij në turbinë. Prerja gjatësore e veprës së marrjes dhe tubacionit të presionit është treguar në figurën 6, struktura ndodhet në shpatin e djathtë të digës. Vepra e marrjes është një strukturë betonarme në hyrje të së cilës ndodhen zgarbat e çelikut dhe portat e punës. Në të janë instaluar dy tuba çeliku me diametër të njëjtte të cilët dërgojnë ujin në turbinë. Materialet që do përdoren për ndërtimin e veprës së marrjes dhe tubacionit të presionit janë beton, hekur dhe pllaka çeliku, plakat e çelikut do të përdoren për prodhimin e zgarbave të çelikut, portave të punës si dhe tubit të presionit.

Shkarkuesi Sipërfaqësor do të ndërtohet në shpatin e majte të digës, seksioni tërthor i të cilit është paraqitur në figurën 7. Shkarkuesi sipërfaqësor përbëhet nga kanali i shkarkimit si dhe 4 porta identike të punës. Kanali i shkarkimit është strukturë betonarme ndërsa portat janë radiale me sistem hidraulik operimi. Materialet që do të përdoren për ndërtimin e kanalit janë beton dhe hekur ndërsa porta e shkarkuesit do të ndërtohen me çelik dhe do të operohen me anën një sistemi hidraulik operimi.





Figura 8: Profili tërthor i godinës së centralit

5. PËRSHKRIMI I PROCESEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE

Ndërtimi i veprës është planifikuar të zgjasë 30 muaj, programi i detajuar i të gjithë proceseve ndërtimore është paraqitur në kontratën koncesionare. Veprat më të rëndësishme të paraqitura në kapitullin 4 do të ndërtohen si më poshtë, Diga e hidrocentralit 22 muaj, Tuneli i deviacionit 6 muaj, Vepra e marrjes dhe tubacioni i presionit 11 muaj, Shkarkuesi sipërfaqësor 14 muaj, Godina e centralit 12 muaj dhe Godina e nënstacioni elektrik së bashku me lidhjen dhe testimin e rrjetit 15 muaj.

Materialet kryesore që do të përdoren në proceset teknologjike të ndërtimit të projektit janë gurë të fraksionuar për ndërtimin e digës, çimento për prodhimin e betoneve, inerte për prodhimin e betoneve, beton, hekur ndërtimi për strukturat betonarme, çelik për prodhimin e tubit të presionit, ujë, energji elektrike, karburant. Proceset kryesore teknologjike janë mbushje dhe ngjeshja e digës, ndërtimi i strukturave betonarme si dhe montimi i pjesëve elektromekanike. Më poshtë po shpjegojmë materialet dhe proceset e ndërtimit.

Gurë të fraksionuar që do të përdoren për ndërtimin e trupit të digës do të jenë 74,00 m³ sipas specifikimeve të projektit të fizibilitetit. Gurorja për furnizimin e projektit me gurë do të ndërtohet në bafin e sipërm të digës në sipërfaqe të cilat do të mbetet nën ujë, duke minimizuar kështu



ndikimin ne mjedis. Për prodhimin e gurëve te franksionuar ne gurore do te instalohet një gurëthyes i cili do e franksionoje gurin ne disa fraksione si dhe do prodhoje inerte për prodhimin e betoneve. Ngarkimi i materialit për ne gurëthyes dhe kamionë do te kryhet me anën e ekskavatorëve me zinxhirë ndërsa transporti i gurëve dhe inerteve do te behet me kamionë

Çimento është materiali baze për prodhimin e betoneve dhe ndërtimin e perdes se çimentimit dhe për gjithë projektin është llogaritur te përdoren rreth 65,000 ton çimento. Ne kantier do te instalohen dy pika depozitimi për çimenton, pika e pare do te ndërtohet pranë impiantit te betonit dhe do ketë dy silose me kapacitet 120 ton secili ndërsa pika e dyte do te krijohet ne impiantin e çimentimit dhe kjo do te ketë dy silose me kapacitet 120 ton secili. Çimento është një material qe do te vije ne me bot transportues nga fabrika dhe do te ngarkohet ne silos.

Inertet për prodhimin e betoneve do te realizohen ne gurore si dhe një pjese tjetër do te blihet nga furnizuesit lokale. Ne total është llogaritur te përdoren rreth 39,000 m³ inerte.

Betonet do te prodhohen ne impiantin e betonit i cili është i instaluar ne kantier dhe ka fuqi prodhuese 100 m³/ore. Ne gjithë projektin është parashikuar te përdoren rreth 39,200 m³ betone. Impianti i betonit është instaluar ne qendër te kantierit dhe objekti me i largët me te është rreth 500 metra, transporti i betonit do te kryhet me mikser betoni.

Hekuri i ndërtimit do te jete me parametrat e përcaktuar ne projekt dhe transporti nga furnizuesi ne kantier do te kryhet me triler. Ne gjithë projektin është parashikuar te përdoren rreth 6,000 ton hekur ndërtimi i cili do te depozitohet ne ndërtese me sipërfaqe 250 m² si është treguar ne plan organizimin e punimeve te kantierit.

Çeliku për prodhimin e tubit te presionit do te importohet me pllaka me përmasa dhe trashësi te ndryshme sipas specifikimeve te projekti dhe do te transportohet ne kantier me trailer. Ne gjithë projektin është parashikuar te përdoren rreth 1,470 ton çelik i cili do te depozitohet ne ndërtesën përkatëse si është treguar ne plan organizimin e punimeve te kantierit.

Uji i cili është i nevojshëm për te gjitha proceset teknologjike te ndërtimit te veprës do te merret nga puse te cilët do te ndërtohen ne breg te lumit dhe do te shpërndahet ne impiantet përkatëse me ane te pompave.

Energjia elektrike qe do te përdoret ne te gjithë impiantet dhe makineritë te cilat punojnë me energji do te merret nga linja ekzistuese 6 kV e cila ndodhet ne kantier. Linja elektrike e ka daljen ne nënstacionin e Krahësit dhe vjen ne kantier tre faze. Sipas specifikave te makinerive do te ndërtohen edhe kabinat elektrike dhe transformatorët përkatës.

Karburanti do te merret ne njësite e licencuara dhe do te depozitohet kantier ne një depozite me kapacitet 10 mije litra.



Mbushja e digës me gurë është procesi teknologjik i cili konsiston ne transport gurësh, mbushje dhe ngjeshje. Ngarkimi i gurëve do te behet ne gurore me ekskavatorë dhe transporti ne dige do te kryhet me kamionë. Hapja e gurëve ne shtresa te caktuara ne projekt do kryhet me dozer me zinxhirë ndërsa ngjeshja e materialit do te kryhet me rrola dhe ujë.

Ndërtimi i strukturave betonarme konsiston ne montimin e armaturave, instalimin e hekurit te ndërtimit dhe betonimin. Armaturat për ndërtimin e veprës do te depozitohen ne vendin e përcaktuar ne plan organizimin e punimeve te kantierit dhe do te shpërndahen neper vepra me kamionë. Përpunimi i hekurit do te kryhet ne vendin e përcaktuar ne plan organizimin e punimeve te kantierit dhe do te shpërndahen neper vepra me kamionë si dhe instalohet ne to sipas specifikime te projektit. Betoni do te transportohet nga impianti i prodhimit te betonit neper vepra me ane te mikserëve te betonit dhe do te hidhet ne to me beton pompë.

Pajisjet elekto-mekanike do te vijnë dhe depozitohen ne kantier, montimi i tyre do te behet ne kohen e përcaktuar ne grafikun e punimeve.

6. LIDHJA ME INFRASTRUKTURËN E NEVOJSHME

Kantieri lidhet me rrugën nacionale Fier – Tepelene ne fshatin Krahes, nga rruga nacionale kantieri ndodhet 9.2 km larg dhe rruga është e asfaltuar nga kryqëzimi me rrugën nacionale deri ne kantier. Kjo rruge do te shërbeje për gjate gjithë ndërtimit te veprës dhe me pas për shfrytëzimin e saj. Duke qene se punimet e gërmimeve te shpateve kane përfunduar ne fazën aktuale nuk ka nevojë për rruge te tjera shërbimi.

Energjia elektrike e nevojshme për ndërtimin e veprës do te merret nga linja 6 kV e cila është e ndërtuar deri ne hyrje te kantierit dhe furnizohet nga nënstacioni i Krahesit.

Uji i nevojshëm për proceset teknologjike dhe nevojat e personelit i cili do te punoje për ndërtimin e hidrocentralit do te merret me ane te puseve te ndërtuara ne breg te lumit. Proceset teknologjike qe kërkojnë sasi te mëdha ja uji janë prodhimi i betoneve dhe ngjeshja e gurëve ne dige, rrjedhimisht për to do te ketë nga linje specifike, gjithashtu një linje për furnizim me ujë do te shkoje ne ambientet e personelit.

Ujerat e ndotur do te grumbullohen me ane te tubave te shkarkimit ne dekatuesin i cili do te nderohet ne pjesën fundore te kantierit. Materialet e ngurta te ujit do te dekantojnë dhe uji i pastër do te dërgohet ne lume.



7. FAZAT E ZHVILLIMIT TE PROJEKTIT

Plani i përgjithshëm i zbatimit mund të ndahet në një fazë para-ndërtimi dhe një fazë ndërtimi.

Puna që do të kryhet në Fazën Para-Ndërtimit përfshin aktivitetet kryesore si më poshtë:


1. Kryerjen e VNM / VNMS-së;
2. Zhvillimi i Tenderit dhe "Projekti i Detajuar / i Zbatimit"¹;
3. Marrja e licencave dhe lejeve;
4. Marrja e tokës dhe shpronësimi;
5. Caktimi i Kontratave të Ndërtimit;
6. Financimi.

Shumica e këtyre aktiviteteve duhet të përfundojnë para fillimit të ndërtimit. Proceset kyçe si, marrja e tokës dhe e licencave dhe lejeve, duhet të përfundojnë para fillimit të punimeve të ndërtimit. Zgjidhja e këtyre çështjeve kryesore është gjithashtu një parakusht për të realizuar "Mbylljen financiare" pasi kredi-dhënësit do të kërkonin konfirmimin mbi mundësinë e përdorimit të tokës dhe lejet e tjera para nënshkrimit të një marrëveshjeje financiare.

Në Marrëveshjen Koncesionare, fillimi i fazës së ndërtimit quhet 'Data e fillimit të punimeve të ndërtimit', e cila do të ndodhë kur të jenë plotësuar një sërë parakushtesh nga Koncesionari dhe Autoriteti i dhënies së Koncesionit. Një nga detyrimet e Koncesionarit është të japë të gjitha kontratat e ndërtimit brenda 6 muajve nga marrja e të gjitha lejeve dhe licencave.

Për HEC-in e Kalivaçit Faza e Ndërtimit do të përfundojë jo më vonë se 30 muaj pas 'Datës së Fillimit të Punimeve të Ndërtimit'.

Afati i Punimeve të Ndërtimit është dhënë në figurën e mëposhtme:




¹ Përcaktuar në Marrëveshjen e Koncesionit si: "Projekti i Detajuar / i Zbatimit" nënkupton propozimin e projektit për çdo impiant, i cili ë do të dorëzohet nga Koncesionari kur të bëjë aplikimin për leje Ndërtimi".



8. LËNDËT E PARA QË DO TË PËRDOREN PËR NDËRTIMIN

Disa nga lëndët e para, të cilat janë të nevojshme gjatë kësaj faze janë të listuar në tabelën në vijim, si dhe shpjeguar ne kapitullin 4.

Lëndët e para	Përdorimi
Gurë te franksionuar	Do te përdoren për mbushjen e trupit te digës dhe do te prodhohen ne guroren qe do te ndërtohet ne kantier
Çimento	Do te përdoret për prodhimin e betoneve dhe ndërtimin e perdes se çimentimit. Furnizimi me çimento do te kryhet nga fabrikat e çimentove.
Inerte	Do te përdoren për prodhimin e betoneve. Një pjese e tyre do te prodhohen ne kantier pjesa tjetër do blihet ne furnizuesit lokale
Hekur ndërtimi	Do te përdoret për ndërtimin e strukturave betonarme dhe do te furnizohet nga subjektet e licencuara
Uji	Uji për përpunimin e materialeve gjate kohës se ndërtimit sigurohet nga uji i përroit .
Energji elektrike	Energjia elektrike do merret nga rrjeti ekzistues.
Karburant	për vënien në pune të makinerive të transportit dhe atyre teknologjike gjate kohës së ndërtimit.
Materiale ndërtimi	do të merren/blihen nga pikat e licencuara



9. LIDHJA E PROJEKTIT ME PROJEKTET E TJERA EKZISTUESE PËRRETH/PRANË ZONËS SE PROJEKTIT.

Nuk ka projekte ekzistuese pranë zonës së projektit.

10. INFORMACION PËR ALTERNATIVAT E MARRA NE KONSIDERATE

Zhvillimi i Hidrocentralit të Kalivaçit sipas marrëveshjes së re, ka alternativa të kufizuar për shkak të kërkesës për tu zhvilluar në vazhdim të punimeve civile të filluara tashmë. Në studimin e fizibilitetit thuhet: "Disa nga punimet në strukturat e HEC-it të Kalivaçit kanë filluar tashmë dhe nuk ka ndonjë arsye teknike dhe ekonomike për ndryshimin e skemës, llojin e strukturave dhe planin e HEC-it".

- *Diga me ekran betoni e mbushur me gurë (CFRD) në Kalivaç, garanton jetëgjatësinë e rezervuarit.*
- *Tuneli i devijimit i kombinuar me tunelin e dërgimit në të njëjtin vend në bregun e majtë të lumit dhe digës*
- *Ndërtesa e Centralit pikërisht në pjesën e poshtme të digës në bregun e majtë*
- *Nënstacioni shumë afër centralit elektrik në shesh në bregun e majtë*
- *Kanali i shkarkimit për kontrollin e përmytjeve në bregun e djathtë të lumit*

Të gjitha përpjekjet për optimizimin e skemës kanë qenë për të përcaktuar rrjedhën e turbinës, numrin dhe kapacitetin e tyre të instaluar.

11. LËNDËT E PARA GJATË FUNKSIONIMIT,

Përfshire sasinë e ujit të nevojshëm, te energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit te tyre.

Lidhur me natyrën e projektimit, kuptojmë që lënda e parë dhe më e rëndësishme për prodhimin e energjisë hidroelektrike është uji. Furnizimi me uji do të kryhet nga vepra e marrjes për të cilat kompania do të pajiset me lejen e përdorimit të ujit. Leja e përdorimit të ujit miratohet nga Autoritetit Kombëtar i Ujit dhe Këshilli i Basenit.

12. AKTIVITETE TË TJERA

Kantieri i përkohshëm për ndërtimin e HEC-it Kalivaç është i organizuar ne katër zona dhe hyrja ne kantier, plan vendosja e gjeoreferuar e te cilit paraqitet ne figurën 1. Zona 1-98 ndodhen ne kuotën 98 m m.n.d dhe do te shërbeje si zyrat e administratës dhe drejtuesve te larte. Zona 2-73 ndodhet ne kuotën 73 m m.n.d. dhe do shërbeje si zyrat, vend pushimet dhe fjetinat e



Ndërtimi i Hidrocentralit Kalivaç

personelit teknik. Zona 3-75 ndodhet ne kuotën 75 m m.n.d. dhe do shërbeje si vend depozitimi dhe ofiçina. Zona 4-75 ndodhet ne kuotën 75 m m.n.d. dhe do shërbeje si vend parkim i makinerive. Me përfundimin e ndërtimit te veprës kantieri do te demontohet dhe ambientet do te rehabilitohen.






Figura Nr. 1 Plan Organizimi i Punimeve

13. INFORMACION PËR LEJET, AUTORIZIMET DHE LICENCAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN

Kompania është na fazën e pajisjes me lejet dhe licencat e nevojshme për të filluar më pas zbatimin e projektit për ndërtimin dhe vendosjen në funksion të veprës hidroenergjetikë. Lejet dhe licencat që duhet të ketë projekti para fillimit të punimeve janë;

- *Vendimi ose Deklarata për VNM*
- *Leja e përdorimit të ujit*
- *Oponenca nga AKBN*
- *Leja e Ndërtimit, është faza e fundit e licencimit. Ne aplikimin për leje ndërtimi kompania duhet të ketë marrë të gjitha lejet, licencat dhe miratimet për projektin nga të gjitha institucionet.*

Pas marrjes së lejes së ndërtimit kompania ka të drejtë të nis punimet për ndërtimin e veprës hidroenergjetikë në përputhje me projektin e propozuar.

14. KOPJE TË LEJEVE, AUTORIZIMEVE DHE LICENCAVE QË DISPONON ZHVILLUESI

Kompania "Ayen-Alb sh.a" zotëron kontratën e koncesionit me nr. rep, nr, datë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

